



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.12.2022

MBLEDHJA Nr. 58,
Datë 12.12.2022, ora 14:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e hënë, datë 12.12.2022, ora 14:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 58 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 06.12.2022 dhe datë 09.12.2022
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin nëntor 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
4. Mbi licencimin e shoqërisë “Albsolar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Albsolar PV Park 1, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendodhje në zonën e Bisht Kamzës, Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI